



1 mars 2017

KOMUNIKATË PËR MEDIA

AKP-ja shpërndan fondet e 20%-it edhe për 508 punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore-mbi gjysmë milioni euro

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), duke e ekzekutuar vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), do të bëjë shpërndarjen e fondeve të 20%-shit të dedikuara për punëtorët e 9 ndërmarrjeve shoqërore (NSh).

Pasi që janë krijuar kushtet ligjore të parapara me legjislacionin në fuqi që e rregullon çështjen e shpërndarjes së fondeve të 20%-it, Agjencia ka përgatitur dokumentacionin përkatës për shpërndarjen e fondeve të 20%-it për punëtorët e kualifikueshëm të këtyre ndërmarrjeve shoqërore, kurse shumën e fondeve që është në procedurë të shpërndarjes kësaj radhe është mbi gjysmë milioni euro, **€ 595,342.65 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzet e dy €uro e 65 cent)**. Nga kjo shpërndarje do të përfitojnë **508** punëtorë që i kanë plotësuar kriteret ligjore për të qenë pjesë në shpërndarje të 20%-it.

Bartja e këtyre fondeve do të bëhet në llogarinë e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) në pajtim me nenin 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime).

Në total, Agjencia deri me tani ka shpërndarë mbi 110 milionë euro dhe nga këto shpërndarje kanë përfituar mbi 46 mijë punëtorë dhe ish punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore. Në ndërkohë, Agjencia është në proces të përgatitjes së dokumentacionit për shpërndarjen e fondeve të 20%-it për punëtorët e kualifikueshëm edhe për disa NSh të tjera, për çka punëtorët e këtyre NSh-ve dhe opinioni i gjerë do të informohen në një të ardhme të afërt.

(Në tabelën më poshtë gjeni emrat e 9 NSh-ve, për të cilat është kompletuar dokumentacioni për shpërndarje, shumën e fondeve në dispozicion për të u shpërndarë dhe numrin e punëtorëve përfitues, ndërsa shpërndarja e fondeve të 20%-it për punëtorët e këtyre NSh-ve është në proces duke u realizuar nga BSPK-ja).



Nr.	Nr. ID i NSh-së	Emri i NSh-së	Regjioni	Nr. i Punëtorëve	Shuma për shpërndarje
1	PRN061	Kosovahidroteknika, në Prishtinë	Prishtinë	66	€ 28,086.76
2	GJI106	Kosovatrans, në Ferizaj	Gjilan	207	€ 69,919.17
3	PRZ043	Zhupa, në Reçan	Prizren	19	€ 22,516.45
4	PEJ073	Ekonomia e pyjeve, në Gjakovë	Pejë	17	€ 17,236.52
5	PRN002	Ferma e derrave, në Miradi të Epërme	Prishtinë	13	€ 198,268.67
6	PRN129	Inginiering, në Prishtinë	Prishtinë	34	€ 113,156.15
7	PRN106	Kosovashped, në Prishtinë	Prishtinë	48	€ 99,808.60
8	PRN025	Krikos, në Prishtinë	Prishtinë	16	€ 38,550.10
9	PEJ001	Mulliri në Gjakovë	Pejë	88	€ 7,800.23
				508	€ 595,342.65

Në total, Agjencia deri me tani ka shpërndarë mbi 110 milion euro dhe nga këto shpërndarje kanë përfituar rreth 46 mijë punëtorë dhe ish punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore. Në ndërkohë, Agjencia është në proces të përgatitjes së dokumentacionit për shpërndarjen e fondeve të 20%-it për punëtorët e kualifikueshëm edhe për disa NSh tjera, për çka punëtorët e këtyre NSh-ve dhe opinioni i gjerë do të informohen në një të ardhme të afërt.

FUND